Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

LISTA E VENDIMEVE TË MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI

**NGA DATA 1 DERI 4 GUSHT 2023**

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1 | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt | NRP-02-1048-2023 |
| 2 | Vendim për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt | NRP-02-1049-2023 |
| 3 | Vendim për lejimin e ndjekjes së trajnimeve në Thesar-MFPT | NRP-02-1050-2023 |
| 4 | Vendim për lejimin e ndjekjes së trajnimeve në Thesar-MFPT | NRP-02-1051-2023 |
| 5 | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues të Festës së Vjeljes së Rrushit" Hardhfest 2023" | NRP-02-1054-2023 |
| 6 | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-1056-2023 |

4.8.2023, Rahovec

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1063 Nr. i faq/Br.str/No.pg 203
Data/Datum/Date 8 / 8 / 23
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë Nr.03/L-147 të datës 13.5.2010 dhe nenit 11 të Rrregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagat dhe kompensimet e tjera të Nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

### Për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt

1. Me këtë vendim lejohet pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për z. Naser Krasniqi, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i gjendjes civile, në Krushë të Madhe, Drejtoria për Adminstratë në Komunën e Rahovecit.

2. I njëjti ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës, në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kurorëzimin e bërë jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës, më datë: 24.7.2023.

3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*A r s y e t i m*

Me kërkesë të palës, z. **Naser Krasniqi,** i cili është në mardhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i gjendjes civile, në Krushe të Madhe, në Drejtorinë për Adminstratë në Komunën e Rahovecit, dhe me autorizimin e Drejtorisë për Administratë të datës 21.7.2023, punëtori i lartcekur ka marë pjesë më 24.7.2023 në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës jashtë objektit të Komunës së Rahovecit, prandaj është e domosdoshme që të bëhet pagesa për punën shtesë jashtë orarit të punës, të paraparë me ligjet dhe aktet e tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Naser Krasniqi,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1048 Nr. i faq/Br.str/No.pg 201
Data/Datum/Date 1/8/23

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 21 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civilë Nr.03/L-147 të datës 13.5.2010 dhe nenit 11 të Rrregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagat dhe kompensimet e tjera të Nëpunësve civilë, neneve 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

**Për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt**

1. Me këtë vendim **lejohet** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për z. **Edon Morina,** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i gjendjes civile në Ratkoc, Drejtoria për Adminstratë në Komunën e Rahovecit.

2. I njëjti ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kurorëzimin e bërë jashtë objektit të komunës dhe jashtë orarit të punës, më datë: 26.7.2023.

3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt të punës sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Arsyetim*

Me kërkesë të palës, z. **Edon Morina,** i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës: Zyrtar i gjendjes civile në Ratkoc, në Drejtorinë për Adminstratë në Komunën e Rahovecit dhe me Autorizimin e Drejtorisë për Administratë, të datës 26.7.2023, ka marrë pjesë në kurorëzimin e shtetasve të Republikës së Kosovës e që është bërë jashtë objektit të Komunës dhe jashtë orarit të punës, më datë **26.7.2023**, prandaj është e domosdoshme që të bëhet pagesa për punën shtesë jashtë orarit të punës, të parapare me ligjet dhe aktet e tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Edon Morina,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Njësia Nr/Br/No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr/Br/No 1049 Nr i faq/Br.str/No.pg 201
Data/Datum/Date 1 / 8 / 23

1050 201
Data Datum 1 8
RAHOVEC


**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**


Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kërkesës me Nr. Prot. 4170 të datës 6.9.2021, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për lejimin e ndjekjes së trajnimeve në Thesar - MFPT

1. Me këtë vendim **I LEJOHET znj. Qëndresa Kryeziu-Hoxha**, Zyrtare për Buxhet dhe Financa, në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Rahovecit, ndjekja e trajnimeve në Thesar.

2. Znj. **Qëndresa Kryeziu-Hoxha** do të marrë pjesë në trajnimin për **Modulin e blerjeve**, të organizuar nga MFPT – **THESAR**.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Njësia e personelit.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

1. ***Znj. Qëndresa Kryeziu-Hoxha,***
2. ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
3. ***Njësia e Personelit dhe***
4. ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT
KRYETARI I KOMUNËS

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kërkesës me Nr. Prot. 4170 të datës 06.09.2021, Kryetari i Komunës merr këtë:

## V E N D I M

**Për lejimin e ndjekjes së trajnimeve në Thesar - MFPT**

1. Me këtë Vendim **I LEJOHET z. Valmir Gashi**, Zyrtar ligjor në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Rahovecit, ndjekja e trajnimeve në Thesar.
2. **Z. Valmir Gashi** do të marrë pjesë në trajnimin për **Modulin e të hyrave**, të organizuar nga MFPT – **THESAR**.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Njësia e personelit.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

1. ***Z. Valmir Gashi***
2. ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
3. ***Njësia e Personelit dhe***
4. ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 7, paragrafi 2, pika 2.2, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e Këshillit Organizues të Festës së Vjeljes së Rrushit "Hardhfest 2023"

1. Caktohet Këshilli Organizues i Festës së Vjeljes së Rrushit "Hardhfest 2023", që do të mbahet më datë: 1, 2 dhe 3 shtator 2023, në këtë përbërje:
   - 1.1. Agron Sokoli, kryesues
   - 1.2. Rumir Zhuniqi, zv. kryesues
   - 1.3. Berat Duraku, anëtar
   - 1.4. Nora Boshnjaku, anëtare
   - 1.5. Erhan Morina, anëtar
   - 1.6. Dea Luma, anëtare
   - 1.7. Saranda Sallteku, anëtare
   - 1.8. Afrim Dina, anëtar
   - 1.9. Albnor Mullabazi, anëtar
   - 1.10. Saranda Shala, anëtare
   - 1.11. Skender Rama, anëtar
   - 1.12. Florent Pista, anëtar
   - 1.13. Gardalin Shtavica, anëtar
   - 1.14. Besmire Bytyqi, anëtare
   - 1.15. Zeqir Pallqa, anëtar
   - 1.16. Betim Zllanoga, anëtar
   - 1.17. Brikena Gashi, anëtare
   - 1.18. Ilir Pista, anëtar
   - 1.19. Muharem Morina, anëtar
   - 1.20. Ardian Rama, anëtar
   - 1.21. Shkumbin Arifi – SHL Kosova, anëtar
   - 1.22. Bejtullah Shehu – Shoqata e Vreshtarëve, anëtar
   - 1.23. Përfaqësues nga Shoqata e Verëtarëve (Enologjia), anëtar

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1054 Nr. i faq/Br.str/No.pg 202
Data/Datum/Date 2/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC

2. Këshilli Organizues, ka për detyrë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përgatitjen dhe organizimin e festivalit, si: shpërndarja e ftesave për grupet dhe individët e ndryshëm, të ndajë çmimet në koordinim me përfaqësuesit dhe të funksionojë si grup avokues dhe promovuese, duke i bashkërenduar aktivitetet me përfaqësuesit e OJQ-së Hardhfest.

3. Këshilli Organizues obligohet që të bëjë monitorimin e implementimit të aktiviteteve dhe të kontrollojë mbarëvajtjen dhe organizimin e Festës së Vjeljes së Rrushit "Hardhfest 2023".

4. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative të organizimit të Festës së Vjeljes së Rrushit "Hardhfest 2023", i takon kryesuesit të Këshillit Organizues.

5. Obligohet Këshilli Organizues që, pas përfundimit të Festës së Vjeljes së Rrushit "Hardhfest 2023", të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e festivalit.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e Këshillit Organizues.

7. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Me vendim të njoftohen:*

- *Anëtarët e Këshillit Oganizues, dhe*
- *Arkivi.*

**Smajl Latifi**

**Kryetar i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60, paragrafi 1. pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. **EQEREM KABASHI** nga Opterusha, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Ofiqar, në Drejtorinë për Administratë, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 30.8.2023.
2. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largojë nga lista e pagave, nga data 30.8.2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Punëtori **EQEREM KABASHI** nga Opterusha, në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Ofiqar, në Drejtorinë për Administratë, **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS,** nga data 30.8.2023.
Sipas detyrës zyrtare, Njësia e personelit ka konstatuar se punëtori i lartpërmendur, me datën 29.8.2023 arrin moshën e pensionimit, ngase i bën 65 vjet.

Prandaj, kryetari i Komunës, pas administrimit të provave dhe të fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit Eqerem Kabashi, nga data 30.8.2023, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga sa u tha më lart, Kryetari i Komunës, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi punëtori ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

***Kopja e vendimit u dorëzohet:***
*1. Punëtorit,*
*2. Drejtorisë për Administratë,*
*3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
*4. Dosjes personale,*
*5. Arkivit.*

**Smajl Latifi**
**Kryetar i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1056 Nr. i faq/Br str/No pg 202
Data/Datum/Date 4/8/23
RAHOVEC / ORAHOVAC